



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	21.06.2021
<b>Referenc-ë:</b>	07-353/04-115577/21
<b>Për/ Za/ To:</b>	“Astronomy Club of Kosova”
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike. <i>Kastrati</i>
	Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar ~~kërkesën me nr~~ protokollin 07-353/04-115577/21 nga “Astronomy Club of Kosova” me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike sheshi, “Zahir Pajaziti” me datë 22.06.2021 nga ora 18:00 deri në 21:00. Qëllimi i aktivitetit është shënimi i Ditës së Verës apo Ekuinoksit Veror ku do të vendosen disa teleskop për vrojtimin e Diellit, Hënës, Planeteve dhe Yjeve.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike sheshi, “Zahir Pajaziti” me datë 22.06.2021 nga ora 18:00 deri në 21:00 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.
- Pas përfundimit të aktivitetit të largohen të gjithë flamujt.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.